



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVETKOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMISIONI DISIPLINOR//DISCIPLINSKA KOMISIJA/ THE DISCIPLINARY COMMITTEE

KD.nr.02/2019

KOMISIONI DISIPLINOR, në përbërje nga gjyqtarët, Nenad Lazić, kryetar, Manushe Karaqi dhe Armend Berisha, anëtarë të Komisionit, në procedurë disiplinore ndaj Xxxx xxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Xxxx xxxx Xxxxx, sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor me numër ZPD-2018-112, në procedurë në Komisioni Disiplinor të KGJK-së ka marrë numrin KGJK/KD/02/2019, për sjellje të pahijshme të përcaktuar sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, dhe shkelje e kodit të etikës profesionale për gjyqtar, sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223), në seancën dëgjimore të mbajtur, në prezencën e përfaqësuesit të ZPD-së znj.Hasime Osmani, dhe gjyqtarit z.Xxxx xxxxx, më datë 18.04.2019, në bazë të nenit 37 paragrafi 1 pika 1.3 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës merr këtë:

V E N D I M

1. Xxxx xxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Xxxx xxxx Xxxxx, **është** përgjegjës për sjellje të pahijshme sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor me numër ZPD-2018-112, i njëjti në procedurë të Komisioni Disiplinor ka marrë numrin KGJK/KD/02/2019, të përcaktuar në nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, dhe shkelje e kodit të etikës profesionale për Gjyqtar, sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.
2. Për shkak të vërtetimit të sjelljes së pahijshme, gjyqtarit Xxxx xxxxx i shqiptohet masa disiplinore Ulje e përkohshme e rrogës për 30% në kohëzgjatje prej tre (3) muaj, duke filluar prej muajit në vijim pasi vendimi të bëhet i plotfuqishëm.

A r s y e t i m

Në Komisionin Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Zyra e Prokurorit Disiplinor ka paraqitur raportin përfundimtar me numër ZPD-2018-112 së bashku me shkresat e lëndës, me të cilin e ka ngarkuar Xxxx xxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Xxxx xxxx Xxxxx, për sjellje të pahijshme të përcaktuara me nenin 34 paragrafi 1, pika 1.2-neglizhencë në kryerje, dështim për të kryer apo abuzimin e funksioneve gjyqësore dhe shkelje e kodit të etikës profesionale për Gjyqtar.

Zyra e Prokurorit Disiplinor përmes Këshillit Gjyqësor të Kosovës e ka pranuar në kompetencë parashtrësën e dërguar nga përfaqësuesja e palës paditëse avokatja Florije Dervinja, në të cilën ka shprehur shqetësimin për vonesë në vendosje të lëndës civile C.nr.245/08, kontest nga marrëdhënia e punës për shqyrtim dhe vendosje, lidhur me sjelljen e pahijshme të kryer nga Xxx xxxxx, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Xxx xxxx Xxxxx. Pasi qe ka zhvilluar hetimin, bazuar edhe në shkresat e lëndës të cilat i ka siguruar dhe deklaratën e gjyqtarit Xxx , ZPD ka gjetur se lëndë ka qenë në punë të gjyqtari Xxx xxxxx nga viti 2012.

Zyra e Prokurorit Disiplinor pretendon se ka gjetur elemente të mjaftueshme për sjellje të pahijshme të gjyqtarit Xxx , dështim për të vendosur në lëndën civile C.nr.245/08, sidomos për shkak të faktit që është rast i natyrës urgjente, kontest nga marrëdhënia së punës dhe ka prioritet ligjor për të vendosur në përputhje me nenin 475 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).Përveç kësaj ka përparësi në vendosje në përputhje me Strategjinë Shtetërore për zvogëlimin e lëndëve të vjetra të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Qarkores së Gjykatës Supreme të Kosovës për zbatim të kësaj strategjie.

Duke i inspektuar shkresat e lëndës, ZPD kishte gjetur se në Gjykatën Themelore në Xxx xxxx Xxxxx është duke u zhvilluar procedurë civile sipas padisë së paditësit Xxxxx xxxxxxxx, kundër të paditurit Komuna e Xxx s, për tu kthyer në vendin e punës dhe pagesën e të ardhurave personale. Padia është pranuar në gjykatë me datën 19.08.2008, dhe me këtë lëndë C.nr.245/08, gjyqtari Xxx xxxxx ishte ngarkuar me 06.08.2012.Veprimin e parë procedural gjyqtari Xxx në këtë lëndë, e kishte ndërmarr ashtu që paditësi i ka dhënë vërejtje gjyqësore me datë 17.09 2015, më të cilën i është dhënë afat prej 7 ditësh nga pranimi i vërejtjes. Paditësi ka pranuar vërejtjen gjyqësore me datë 02.10.2015, dhe ka paguar taksën gjyqësore me datë 05.10.2015.Paditësi në lëndë e kishte paguar taksën gjyqësore dhe ekziston vërtetimi në shkresat gjyqësore të rastit konkret, gjyqtari Xxx në mungesë të fletëpagesës, e kishte nxjerr aktvendim me datë 14.01.2016, me të cilin konsiderohet se padia është tërhequr. Me datë 23.02.2016, përfaqësuesi i paditësit në lëndë, i ka paraqitur gjykatës propozimin për kthim në gjendje të mëparshme. Gjyqtari Xxx me aktvendimin C.nr.245/08, datë 07.04.2017, e ka lejuar kthimin në gjendje të mëparshme dhe me datë 07.11.2017 është marrë aktvendim qe pala e paditur Komuna e Xxx s obligohet që gjykatës ti paraqet përgjigje me shkrim në padi. E njëjta lëndë me datë 27.03.2018 e pa përfunduar, i është ndarë në punë gjyqtarit tjetër.

Gjyqtari Xxx xxxxx në seancën dëgjimore të Komisionit Disiplinor të mbajtur me datë 18.04.2019 ka deklaruar se është e vërtet se lëndën konkrete C.nr.245/2008 e ka pranuar me datë 06.08.2012, kur është emëruar edhe gjyqtar i Gjykatës Themelore në Xxx xxxx Xxxxx. Kur ka filluar punën, sipas gjyqtarit Xxx lëndët i kishte pranuar me thasë dhe se ka qenë e pa mundur qe ti sistematizoj të njëjtat dhe ta dijë se të çfarë natyrë janë. Gjatë shqyrtimit të lëndëve të vjetra, gjyqtari lëndën konkrete e kishte punuar dhe e kishte dërguar një vërejtje sa i përket taksës gjyqësore. Në realitet taksa ishte paguar mirëpo administrata e gjykatës nuk ja kishte dërguar fletëpagesën. Kur pala e ka sjell kopjen e fletëpagesës së taksës, në të njëjtën kohë ka bërë kërkesë

për kthim në gjendje të mëparshme. Me ardhjen në punë të gjyqtares së re, lënda ka kaluar në punë tek e njëjta. Një numër të lëndëve, nga 10 lëndë të secilit vit, nga 2008 e deri 2010 ja kam dërguar gjyqtares xxxxx xxxxxx. Nuk e kishte ditur që lënda konkrete, është pjesë e këtyre lëndëve të bartura tek gjyqtarja Xxxxxx, sepse në të kundërtën sipas gjyqtarit Xxxx , nuk do të ja kishte bartur por do ta kishte punuar vetë. Është gjyqtar nga Xxxxxx dhe nuk i ka njohur palët dhe sipas gjyqtarit nuk ka pasur asnjë qëllim, por e gjithë kjo ka ndodhur për shkak të ngarkesës së madhe me lëndë. Ka pasur shume lëndë të vjetra, ka punuar me lëndë të vitit 2000, 2002, 2003 dhe 2004 dhe përveç kësaj ka pasur edhe lëndë të tjera nga marrëdhënia e punës.

Në fjalën përfundimtare, përfaqësuesja e Zyrës së Prokurorit Disiplinor deklaroj se gjatë hetimit, ZPD ka gjetur neglizhencë nga ana e gjyqtarit Xxxx , sepse përveç që e ka mbajtur lëndën nga viti 2012 dhe i ka ndërmarr disa veprime vetëm sa i përket taksës, i njëjti duke e parë që lënda konkrete të ai ka qëndruar me tepër se pesë(5) vite, të njëjtën nuk e ka përfunduar, por e ka bartur tek gjyqtari tjetër.

Gjyqtari Xxxx në fjalën përfundimtare ka deklaruar se ai asnjë herë nuk ka pasur problem dhe ka punuar shumë. Rastin konkret kontest nga marrëdhënia e punës, nuk e ka neglizhuar dhe se nuk ka pasur ndonjë qëllim, por e gjithë kjo vonës sipas gjyqtarit Xxxx kishte ndodhur për shkak të ngarkesës së madhe me lëndë dhe gjithë këto lëndë nuk kishte pasur mundësi me i sistematizuar sipas llojit. Kur i ka bartur lëndët të gjyqtarja xxxxxx, nuk e kishte ditur që në mesin e këtyre lëndëve është edhe lënda konkrete.

Komisioni Disiplinor i administroj të gjitha provat në shkresat e lëndës, ka dëgjuar edhe deklaratën e gjyqtarit Xxxx të dhënë gjatë seancës dhe pasi i ka shqyrtuar dhe analizuar, ka konstatuar se ekziston përgjegjësia disiplinore e gjyqtarit.

Sipas vlerësimit të Komisionit, qëndron pretendimi i Zyrës së Prokurorit Disiplinor, së gjyqtari Xxxx ka kryer sjellje të pahijshme më të cilën është ngarkuar dhe se rrethanat e shumta lehtësuese të cilat i cekur dhe ekzistimi i të cilave është i sigurt, nuk janë të ndërlidhura nga ekzistenca e shkeljes disiplinore. Gjyqtari Xxxx është dashur që të jetë me i kujdesshëm, lëndët dhe zyrën ta menaxhoj me mirë, në mënyrë që të mos vije deri të vonesa e me shumë se 5 vite e zgjidhjes së lëndës kontestuese, e cila për nga natyra ka qenë lëndë me prioritet, kontest nga marrëdhënia e punës. Gjyqtari Xxxx me aktvendim C.nr.245/08, datë 07.04.2016 e kishte kthyer në gjendje të mëparshme në mënyrë që procedura sipas kësaj çështje është kthyer në fazën e dhënies së Aktvendimit mbi tërheqjen e padisë, të datës 14.01.2016, i cili aktvendim është shfuqizuar sipas kërkesës së palës dhe në bazë të këtij aktvendimi. Nga kjo datë, e deri me 07.11.2017 kur gjyqtari Xxxx me aktvendim C.nr.245/08 e detyron të paditurën Komuna e Xxxxxx me seli në xxxxxx që në afat prej 15 nga dita prej ditës së pranimit të padisë, të përgjigje me shkrim në padi, nuk kishte ndërmarr asnjë veprim dhe me datë 27.03.2018, lënda kontestuese i kalohet gjyqtarit tjetër.

Në seancën për këshillim dhe votim, Komisioni njëzëri vendosi së gjyqtari Xxxx xxxxx është përgjegjës për sjellje të pahijshme të një gjyqtari sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2-neglizhencë në kryerjen e detyrave, dështim për të kryer, dhe shkelje e Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar.

Lidhur me këtë konstatim, Komisioni në mënyrë unanime i shqipton masën disiplinore **Ulje e përkohshme e rrogës për 30% në kohëzgjatje prej tre (3) muajve**, duke filluar prej muajit të ardhshëm pasi vendimi të bëhet i plotfuqishëm.

Në bazë të nenit 37 paragrafi 1 nën pikën 1.3 dhe paragrafit 2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës u vendos si në disipozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR
KD.nr.02/2019, datë 18.04.2019

Kryetar i Komisionit Disiplinor
Nenad Lazić

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në Prishtinë, brenda 15- ditësh nga dita e pranimt të Vendimit.

Vendimi u dërgohet:

- Skender Çoçaj, kryesues i KGJK-ës;
- Arianit Salihu, u.d drejtor i Zyrës së Prokurorit Disiplinor;
- XXXXXX XXXXXX, kryetar në Gjykatën Themelore në XXXXX;
- XXXX XXXXX, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në XXXX XXXX XXXXX;
- Departamentit të Administratës dhe Personelit në SKGJK;